

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, nr. 110, Prill - Qershor 2023
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter Hysaj
Ky numër u sponsortizua nga: **Adrian Abazi (Itali)**



JO PAKICË GREKE NË HIMARË, PO HIMARJOTË ME SHTETËSI SHQIPTARE DHE GREKE

Përsëri Athina zyrtare, duke marrë shkas nga ndalimi i një shqiptari të vetëshpallur grek, ripërsëriti tezën e vjetër se Himara është greke. Ministri i Jashtëm Dendias dhe vetë kryeministri Micotaqis kërcënuan se, pa respektimin e të drejtave të minoritetit grek, Shqipëria do t'i ketë të mbyllura dyert e BE-së. Po a ka popullsi greke në Himarë? Kësaj pyetjeje historianët dhe studiuesit shqiptarë i kanë dhënë përgjigje me një varg veprash, ndër të cilat po përmendim "Historia

e Himarës (2002) të studiuesit himarjot Aleko Rrapo, "Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve" (2005) të akad. Kristo Frashërit, "Ipet e Iperit - Himariotët" (2004) të Foto Bixhillit etj. Edhe autori i këtij shkrimi i është përgjigjur kësaj pyetjeje në librin "Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike" (2004), si dhe në artikuj të botuar në shtypin shkencor e të përditshëm. Siç dihet, ndër kriteret dalluese për një pakicë etnike janë...

Faqe 6



NJË VIZITË TE EKSPOZITA "PATRIOT" E ARTISTIT KALLARATAS, SAIMIR STRATI NË TIRANË



Faqe 9

KALLARATI KUJTON

DËSHMORËT QË DHANË JETËN PËR MBROJTJEN E FSHATIT NGA SULMET E ANDARTËVE GREKË NË VITET 1912-1914

LAVDI DËSHMORËVE
TË KALLARATIT,
RËNË MË 1912 - 1914
NË MBROJTJE TË
FSHATIT NGA
ANDARTËT GREKË

DËSHMORË TË ATDHEUT:

1. HYSO B. XHAFERAJ
2. MURAT A. DEMIRAJ
3. DERVISH S. MAÇAJ
4. RAMADAN M. HOXHAI
5. ÇELO M. BOSHAI

VDEKUR NË INTERNIM
NE GREQI:

1. MUÇO B. KARABOLLAJ
2. SALI MAÇAJ
3. YZEIR M. RIBAJ



Faqe 2-3

NË FESTIVALIN E KATËRT "NETËT
E BEJKËS SË BARDHË", KRAHAS
SHUMË ÇMIMEVE ME EMRAT E
PERSONALITEVE TË SHQUARA
TË KËNGËS LABE, JEPET EDHE
DIPLOMA "HYSO XHAFERAJ"



Nga data 9-10 qershor 2023 në Pilur, në kryeqendrën e Polifonisë Labe, u zhvillua Festivali i Katërt "Netët e Bejkës së Bardhë", organizuar nga Bashkia e Himarës, nën drejtimin e drejtorit të Festivalit, zotit Kristo Çipa "Mjeshtër i Madh". Në çmimet e dhëna grupeve dhe interpretuesve më të mirë të festivalit, si: Çmimi "Lefter Çipa", "Feti Brahimi", "Maliq Lila", "Nertesë Asllani" etj., nga organizatorët...

Faqe 8

TAKIM BREZASH
"NA BASHKON
MBIEMRI
GJONBRATAJ"

Faqe 6

KALLARATI KUJTON DËSHMORËT QË DHANË JETËN PËR MBROJTJEN E FSHATIT NGA SULMET E ANDARTËVE GREKË NË VITET 1912-1914

Më 7 maj 2023, në një ditë të bukur pranvere, në Kallarat, në vendin e quajtur "Fshati i Djegur", pranë lapidarit ngritur në kujtim të pesë dëshmorëve që dhanë jetën për mbrojtjen e fshatit nga sulmet e andartëve grekë në vitin 1914, u rivendos pllaka, ku janë skalitur emrat e tyre, të cilët qëndrojnë në përjetësi.

Në këtë ngjarje me shumë rëndësi morën pjesë: kryetari i bashkisë së Himarës z. Jorgo Goro, deputeti i zonës z. Vullnet Sinaj, banorë të Kallaratit, pasardhës të dëshmorëve, ardhur nga Tirana e Vlora.

E veçanta e kësaj ngjarjeje ishte pjesëmarrja e miqve nga Gjirokastra, poetit Nexhip Onjea, kryetar i shoqatës së Fushëbardhës dhe drejtues i grupit "Bilbilat e Fushëbardhës"; z. Irfan Bilbili, sekretar i shoqatës "Labëria", dega Tiranë dhe kryetar i Shoqatës së fshatit Vajzë të Vlorës; Profesor Zaho Golemi po nga Fushëbardha, por edhe kryetar i shoqatës Labëria, dega Tiranë; z. Arben Bllaci, poet, publicist e kryeredaktor i gazetës "Lunxhëria"; z. Trifon Golemi, ish-kryetar i shoqatës së Fushëbardhës; mbi të gjitha, prania e grupit të dëgjuar "Bilbilat e Fushëbardhës", ardhur enkas për të kënduar në këtë tubim patriotik e atdhetar në Kallarat.

Ishin të pranishëm: Kryetari i shoqatës z. Kastriot Karaboli, sekretari i shoqatës "Kallarati" z. Hasan Mehmetaj; kryetari i fshatit z. Lefter Qejvani etj.; po ashtu edhe familjarë e të afërm të dëshmorëve të 1914-ës, nipa e stërnipa të tyre, si Luto Demiri, Gramoz Xhaferaj, Bako Xhaferaj, Ardit Hysi, Zeqo Hoxhën, Hekuran e Hetem Ribaj etj.

Ndodhur në Kallarat për vizitë te miqtë e vetë, mori pjesë edhe avokati Dhimitër Muslia nga Tropoja me dy miqtë e tij nga Ferizaj i Kosovës, emigrantë në Itali.

Fjalën e hapjes e mbajti z. Besnik Gjonbrataj, nënkryetar i Shoqatës, i cili në fjalën e tij iu drejtua pjesëmarrësve: "Në emër të shoqatës Kallarati, në emër të këshillit të fshatit, por edhe në emër të banorëve të këtij fshati, Ju uroj "Mirë se erdhët" në fshatin e djegur të Kallaratit, në këtë fshat rrënojë, por me histori të lashtë e larë me gjak nga të parët tanë për mbrojtjen e trojeve nga sulmet e andartëve grekë. Është kënaqësi e veçantë, por edhe vlerësim që sot në këtë ditë të bukur, në një vend piktoresk, tamam si në ballkonin e Lumit të Vlorës, do ta quaja, të kemi kaq shumë miq e personalitete të veçanta.

Kallarati është vizituar nga shumë drejtues të pushteteve para e pas 90-ës; ka pritur e përcjellë figura të shquara, por ndoshta është hera e parë që një pushtetar lokal e një deputet i popullit të ngjitet deri këtu. Po ashtu, është hera e parë që ky vend me histori më vete të jetë vizituar nga miq të tillë të Labërisë – nga Fushëbardha, Lunxhëria e Vajza, por jo vetëm. Paçi këmbën e mbarë dhe herë tjetër ardhshi jo vetëm për përkujtim ngjarjesh të rëndësishme historike si kjo, por edhe për realizim projektsh turistike, pasi ky terren është shumë i favorshëm për ngjitje alpinistike, pse jo edhe ndërtimin e një fshati të vogël turistik. Ky vend, me përfundimin e rrugës së Lumit të Vlorës, meriton më tepër vëmendje jo vetëm nga pushteti vendor, por edhe nga vetë biznesmenët kallaratas e të tjerë, pse jo edhe nga studiuesit e trashëgimisë kulturore.



Por sot ne kemi miq të veçantë, përfaqësues nga shoqata e Fushëbardhës Gjirokastrë dhe e Vajzës së Vlorës, si dhe miq e shokë të tjerë. Po cila është arsyeja që jemi pikërisht këtu dhe përse kjo lloj pjesëmarrje kaq e gjerë?

Kallarati është një fshat i vjetër, i cili më parë ka qenë i vendosur rrezë Kunjovës, midis Bolenës dhe Kuçit, një fshat i madh që siç thotë rapsodi popullor: "Kallarati për veri/ në Kunjovë për karshi,/ një mij" e dyqind shtëpi,/ me dyqanë e magazi/, ra kolera e bë kërdi,/ në një ditë treqind e dy."

Pra, sipas gojëdhënave dhe dokumenteve të asaj kohe, thuhet se, nga shkaku i sëmundjes së rëndë të kolerës, që ra rreth viteve 1660-1720, kallaratasit u shpërndanë në shumë fshatra fqinje, si: Pilur, Borsh, Piqerras, Sasaj, Lukovë, Shën-Vasil e gjetkë, madje edhe në ishujt e Greqisë, si në Strakëna. Pjesa më e madhe e tyre u vendosën pikërisht këtu në këtë pllajë rrezë Bogonicës, të quajtur Pelingri, duke ndërtuar një fshat me një

kundër andartëve, u detyruan ta braktisin fshatin dhe të strehoheshin në Vranisht e Mesaplik Andartët dogjën e bënë shkumb e hi me gjithë ç'kishin brenda të gjitha shtëpitë dhe xhaminë: nga rreth 130 shtëpi, shpëtuan vetëm tri. U grabitën afro 1500 kokë bagëti të imta, mjaft qe, lopë e kuaj. Në këtë luftë të përgjithshme për mbrojtjen e trojeve u vranë shumë andartët grekë, midis tyre edhe kapiten Cullaqi, por nga fshatit tanë mbetën të vranë: Hyso Xhaferaj, Murat Demiraj, Dervish Maçaj, Ramadan Hoxhaj, Çelo Boshaj. Ndërsa të tjerë kallaratas si Muço Barjam Karabollaj, Yzeir Medin Ribaj e Sali Maçaj, u kapën nga andartët dhe u burgosën në ishullin grek të Korfuzit, ku u torturuan deri në vdekje. Mjaft të tjerë si Cane Demiri, i cili vdiq nga plagët, Rexhep Bego, Lulo Gjoni, Nebo Qejvani, Isa Petani, Feim Strati, Demir Demiri, Xhebro Boçaj e Hito Boçaj u plagosën.

Pasi ushtria pushtuese italiane përzuri grekët më 1916, banorët u kthyen në fshat, që ishte bërë i pabanueshëm dhe u vendosën pranë arave, në të dy krahët e lumit Shushica. Nga ai fshat i bukur, më i bukur i luginës së Shishicës, sot kanë mbetur vetëm rrënojat e shtëpive dhe toponimi "Fshati i Djegur"

Jehona e kësaj qëndrese të armatosur është përcjellë nga brezi në brez nëpërmjet rrëfimeve të të parëve dhe këngëve popullore. Kësaj lufte heroike rapsodi i kohës i thuri vargjet: Ç'ka Harca e madhe që qa/ Tymi si mjegull u ça/ Mavrova kundrejt e pa/ Kallarat u bë hata/ Luftojnë burra e gra.

Pesë të vranët në këtë betejë me andartët grekë janë shpallur Dëshmorë të Atdheut dhe në nderim të tyre është ngritur shumë vite më parë ky lapidar dhe pllaka që përjetëson emrat e tyre.

planimetri për t'u marrë shembull edhe sot.

Sulmet e andartëve grekë në vitet 1912-1914 bënë që banorët, pas qëndrese të fortë





Jo më shumë se një muaj më parë ishim pikërisht në këtë vend me një mision e detyrë tjetër, për një emision televiziv me gazetaren e njohur te News 24 Anila Ahmataj e regjisorin Ardit Zotaj, kushtuar Bilbil të labërisë, djalit të fshatit tonë, këngëtarit të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, Hyso Xhaferaj, që trashëgoi me meritë emrin e stërgjyshit të tij Hyso Balil Xhaferaj, dëshmorit të 1914, por ky jo me pushkë, por me zërin e tij pushkë, duke na bërë krenarë si fshat, por edhe si Labëri. Miku dhe shoku i Hysos, poeti gjirokastrit i Fushëbardhës, Nexhip Onjea, duke qenë i pranishëm në këtë vend, në shenjë respekti e mirënjohjeje për Hyson e dyfekut dhe Hyson e këngës, mori përsipër rifreskimin e pllakës në nderim të këtyre pesë dëshmorëve, e cila për shkak të kohës së gjatë ishte dëmtuar. Dhe Nexhipi e mbajti fjalën e dhënë, jo se ne vetë si shoqatë e të afërmit e dëshmorëve nuk e kishim në plan një gjë të tillë, por Nexhipi e përshpejtoi, ashtu siç bën mirë dhe shpejt çdo punë të tijën nëpërmjet vargjeve. Dhe prandaj sot ndodhemi pikërisht këtu, në pritje për të zbuluar pllakën e re”, përfundoi fjalën e tij Besniku.

Më tej, kryetari i bashkisë z. Jorgo Goro dhe poeti Nexhip Onjea zbuluan pllakën ku janë skalitur emrat e dëshmorëve të 1914-ës dhe të atyre që vdiqën nga torturat burgjeve të Greqisë. Pastaj, në emër të bashkisë së Himarës, të shoqatës së Fushëbardhës, shoqatës “Kallarati” dhe të pasardhësve të dëshmorëve, para lapidarit u vendosën kurora dhe lule.

Në emër të shoqatës së Fushëbardhës i përshëndeti pjesëmarrësit profesor Zaho Golemi, i cili në fjalën e tij vlerësoi lart kontributin e kallaratsve për liri jo vetëm në vitet 1912-1914, por edhe më herët. Historia e fshatit Kallarat është një copëz e historisë së Labërisë. Ajo është e mbushur me akte trimërie e heroizmi, sikurse gjithë historia e trevës labe. Sipas historianit Zaho Golemi, Kallarati nuk ka vetëm 27 dëshmorë, por duhet të ketë edhe 14 të tjerë, rënë në beteja për truallin arbëror, që plotësojnë kriteret ligjore për t’u shpallur “Dëshmor i Atdheut”, si: katër burra të varuar në Janinë: Meçe Meçaj (1790–1847), Lame Petani (rreth 1800–1847) dhe kajmekami Dervish Qejvani (1805–1847), Birbil Toçi (1810–1847); dy luftëtarë trima të rënë në Luftën e Lëkurësit: Balil Xhaferi (1830–1878) e Dalan Qejvani (1840–1878); tre trima të Kallaratit të rënë në luftimet për mbrojtjen e Janinës: Likë Brahimi (1878–1913), Ali Gollosi (1882–1913), Bilbil Hysaj (Dautaj) (1879–1913), që ranë te “Pesë Puset” në Bezhan të Janinës; katër bij të

Kallaratit që vdiqën nga torturat çnjerëzore në burgun e kalasë së Korfuzit, sepse pritën me armë pushtuesit grekë në Vumlo të Pilurit: Muço B. Karabolli, Yzeir M. Ribaj, Maliq Boshi, Sali Maçi si dhe Cane Demir Demiri, i cili vdiq nga plagët e shumta që mori në luftën e 1914-s, përfundoi fjalën e tij z. Golemi.

Në emër të pasardhësve të dëshmorëve të 1914-ës i falenderoi pjesëmarrësit, stërnipi i dëshmorit Hyso Balil Xhaferaj, Bako Xhaferaj. Një falënderim të veçantë Bakuja u bëri shokëve të vëllait, Hysos, ardhur nga Gjirokastra dhe jo vetëm.

Avokati Dhimitër Muslia nga Tropoja, i ndodhur rastësisht në Kallarat me dy miqtë e tij nga Ferzaj i Kosovës, u shpreh se ndihej shumë i vlerësuar që iu dha rasti të merrte pjesë në këtë veprimtari shumë të rëndësishme së bashku me miqtë e tij kosovarë. Të kujtosh dëshmorët, do të thotë të kujtosh historinë e lavdishme të popullit. Ai theksoi se marrëdhëniet e shkëlqyera jug-veri i shërbejnë ecjes përpara të vendit, ndërsa

rrugën e Lumit të Vlorës, ndërtuar kohët e fundit nga qeveria shqiptare nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të kryeministrit Edi Rama, e krahasoi me rrugën e Kombit, e cila i ka dhënë zhvillim pjesës veriore të Shqipërisë dhe Kosovës, prandaj edhe kjo rrugë do ta zhvillojë shumë Lumin e Vlorës, përfshi Kallarat.

Në emër të bashkisë së Himarës përshëndeti kryetari, z. Jorgo Goro, i cili vlerësoi lart organizimin e veprimtarisë në nderim të dëshmorëve të 1914-ës, si dhe vlerësoi kontributin e kallaratsve për liri e çlirim kombëtar në të gjitha luftërat e zhvilluara, ku është dashur të mbrohej vendi, si dhe kontributin që Kallarati jep sot, si pjesë e bashkisë së Himarës.

Gjithashtu, përshëndeti edhe deputeti i zonës z. Vullnet Sinaj, i cili, pasi falënderoi shoqatën “Kallarati” për ftesën dhe organizimin e shkëlqyer të veprimtarisë kushtuar dëshmorëve të Kallaratit në mbrojtje nga sulmet e andartëve grekë më 1914, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e kujtimit të historisë, duke dhënë mesazhin

se duhet të shohim përpara drejt harmonisë e zhvillimit dhe duke hedhur në koshin e plehrave të historisë figurat që nxisin urrejtje ndëretnike etj. I mahnitur nga pozita gjeografike e fshatit të djegur, deputeti dha gjithashtu mesazhin që ky vend, në bashkëpunim edhe me bashkinë, duhet të kthehet në një vend që të vizitohet nga turistët.



Në përfundim të veprimtarisë, për të gjithë pjesëmarrësit u dha një drekë në klubin e Zeqo Hoxhës, e cila kaloi mjaft bukur me shëndete e dolli, si dhe nën këngët e bukura të grupit të Fushëbardhës dhe të Kallaratit.

Kryesia e Shoqatës falenderon të gjithë pjesëmarrësit, në mënyrë të veçantë kryetarin e bashkisë z. Jorgo Goro, deputetin z. Vullnet Sinaj, poetin Nexhip Onjea dhe gjithë miqtë e tij, me grupin “Bilbilat e Fushëbardhës”, të cilët e gjetën kohën të bashkoheshin me ne në këtë përkujtimore për dëshmorët e 1914-ës; pasardhësit e dëshmorëve, banorët e Kallaratit dhe të gjithë të ardhurit nga Tirana e Vlora. Një falënderim të veçantë për bashkëfshatarët: Myzafer Qejvani, Ilir Memushaj, Vangjel Ribaj, Bastri Gjonbrataj, Brahim Goxhaj etj, që me pasion e dëshirë punuan për vendosjen e pllakës dhe transportimin e të ardhurve për në fshatin e djegur. Falënderim i veçantë edhe për gjithë personelin e klubit të Zeqo Hoxhajt për pritjen dhe shërbimin e kuturuar.

Një falënderim special për zotën Ardit Zotaj dhe Erti Ahmataj, të cilët filmuan dhe fotografuan gjithë aktivitetin.

Kryesia e shoqatës “Kallarati”

7 PRILL 1939



ISH-VETERANI SEIT JONUZAJ

PUSHTIMI ITALIAN I SHQIPERISE DHE QENDRIMI I KALLARATASVE

Agresioni i armatosur kundër vendit tonë që ndërmori Italia fashiste me kryeministër Benito Musolinin, i mbiquajtur "Duçe" (Udhëheqës), më 7 prill 1939 i duhej asaj për përmbushjen e qëllimeve imperialiste, për ta shndërruar Shqipërinë në koloni të saj, për grabitjen e pasurive dhe për shfrytëzimin e pozitës strategjike të saj, me qëllim që ta përdorte territorin shqiptar si bazë niseje për pushtimin e vendeve të tjera të Ballkanit. Agresioni fashist italian kundër vendit tonë ishte pjesë e politikës agresive të shteteve fashiste për skllavërimin e popujve dhe për vendosjen e hegjemonisë botërore që shpuri në shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Njëkohësisht ai ishte rezultat i qëndrimit kapitullues, antikombëtar i regjimit të mbretit famëkeq Ahmet Zogu. Ahmet Zogu dhe klika e tij nuk morën asnjë masë për t'i bërë ballë rrezikut që i kanosej vendit, por përkundrazi, sabotuan edhe qëndresën e armatosur popullore. Rreziku i drejtpërdrejtë i agresionit fashist ngriti në këmbë gjithë popullin shqiptar, i cili u hodh në demonstrata të fuqishme antifashiste duke kërkuar armë të mbronje atdheun. Si në mbarë vendin, edhe në Kallarat agresioni fashist italian dhe pushtimi i Shqipërisë më 7 prill 1939 u prit me brengë e hidhërim të madh, si një ngjarje tragjike që tronditi çdo kallaratas. Mungesa e plotë e mjeteve të informimit publik të asaj kohe bënte që lajmet dhe komentet në prag të pushtimit të mbërrinin në Kallarat duke u përcjellë gojë më gojë, shpesh kundërthënëse e kaotike. Disa nga lajmet thoshin se mbreti ka marrë masa dhe do të luftojë edhe vetë për të mos lejuar pushtimin e vendit. Të tjerat thoshin se Italia është fuqi e madhe e nuk matemi dot me të. Por kallaratasit, si atdhedashës të të gjitha kohërave që u dhimbsej atdheu, nuk i besonin asnjë propagandë të vënies në gjumë apo disfatiste, kapitulluese. Prandaj të gjithë ata që u ndodhën në fshat, u grumbulluan në Qafë të Ubavit, ku shprehën vendosmërinë për ta pritur me pushkë agresorin. Një grup i madh burrash u nisën për në komunën e Kuçit që të kërkonin armë për të shkuar drejt porteve detare ku pritej zbarrimi i trupave ushtarake italiane. Në komunë, ku gjetën edhe kuçiotë, bolenas etj., morën përgjigje nga titullarët e saj se mbreti i kish marrë masat për mbrojtjen e vendit, prandaj nuk ishte e nevojshme të armatoseshin dhe as të shqetësoheshin. Kallaratasit u kthyen në fshat të zemëruar nga kjo përgjigje.

ZBARKIMII FORCAVE USHTARAKE ITALIANE NË SHQIPËRI DHE QËNDRESA NDAJ TIJ.

Pra, mbrojtje të organizuar shtetërore ndaj agresionit italian nuk pati. I vetëshpalluri mbret i shqiptarëve, Ahmet Zogu, e la popullin në mëshirën e fatit dhe u largua nga vendi, duke rrëmbyer nga Banka e Shtetit edhe arkat me ar. Vetëm qëndresë spontane pati, kryesisht nga vullnetarë atdhedashës të popullit dhe aty-këtu, si në Durrës e Bestrovë të Vlorës, edhe nga ushtarakë patriotë. Për rrjedhojë, trupat ushtarake të ardhura me anije luftarake të shumta e të mbështetura nga aviacioni ushtarak, në mëngjesin e 7 prillit, "të premtën e zezë", siç e quajti populli atë ditë fatkeqe,

Sipas shënimeve të ish-veteranit Seit Jonuzaj (ndarë nga jeta)



nisen zbarrimin në portet shqiptare të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit e Sarandës. Nga qëndresat e organizuara, më të fuqishmet qenë ajo e Durrësit dhe e Bestrovës së Vlorës. Në Vlorë qëndresë nga vullnetarë popullorë pati në zonën e Skelës, ku u vra fshatari Hamit Vashko nga Gumenica, por qëndresa më e fortë e më e organizuar u bë në Bestrovë, ku mbërriti me ngut nga Elbasani një bateri e artilerisë kundërajrore e komanduar nga togeri atdhetar kallaratas Shahin Osman Jonuzaj. Kjo bateri artilerie bashkë me një repart këmbësorie të komanduar nga Neshat Kolonja, si dhe me vullnetarë të fshatrave përreth u vendosën në kodrat zotëruese të rrugës automobilistike Vlorë-Fier. Qëndresa e Bestrovës i detyroi

trupat fashiste, që ishin duke marshuar nga Vlorë për në Fier, të bllokoheshin për dy ditë rresht (7 e 8 prill) dhe të pësonin shumë të vrarë e të plagosur nga topat e baterisë së artilerisë së komanduar nga Shahini.

Për këtë qëndresë, studiuesi dhe historiani ushtarak italian Mario Montaresi shkruan: "Vështirësi të mëdha ndeshi kolona jonë. Në ora 6 e 30 filloi zbarrimi. Goditjet e para na u dhanë në molin e Vlorës nga ana e forcave shqiptare e, pas zbritjes, forcat tona nisën përparimin drejt Fierit. Në atë kohë forcat shqiptare na kundërshtuan me zjarr në lartësinë e Bestrovës natën e 7 prillit. Shqiptarët ishin vendosur mirë në pozicionet e tyre. Në mbrëmje kolona jonë ishte në kontakt të ngushtë me shqiptarët,

prandaj nuk mund të përparonte më drejt Fierit. E patëm të vështirë për të kaluar Bestrovën. Më 8 prill forcat tona marshuan drejt Fierit. Këtu, dëmet tona janë 93 ushtarë, nënoficerë e oficerë të vrarë e të plagosur".

Pas pushtimit të Shqipërisë, pushtuesit menjëherë nisën fashistimin e vendit, duke vendosur rregullat dhe simbolet e tyre në të gjitha fushat e jetës. Nisën burgosjet e kundërshtarëve dhe përjashtimet e të rinjve antifashistë nga shkollat. Një nga viktimat e parë të kësaj politike ishte edhe i riu kallaratas Mumin Selami, që shkroi mbi një libër fill pas pushtimit të vendit fjalët kuptimplote: "Mbi kockat e martirëve ngrihet atdheu". Ai u përjashtua nga shkolla dhe u burgos si antifashist.

Gjendja e rëndë ekonomike i detyroi shumë kallaratas, sidomos moshat e reja, të largoheshin nga fshati në kërkim të ndonjë pune në sipërmarrje e shoqëri të ndryshme italiane për të siguruar bukën e gojës për vete e për familjet e tyre që linin pas. Dhe megjithëse kryenin punë të rënda krahu e me orar të zgatur, 10-12 orë në ditë, pa kushtet më elementare jetese, duke fjetur nëpër baraka apo në qiell të hapur nëpër ullishtet e Vlorës e gjetkë, merrnin një pagë minimale. Prandaj ata nisën të merrnin pjesë në protesta e demonstrata që organizoheshin kundër pushtuesve fashistë italianë.

Punëtorët kallaratas, si gjithë punëtorët e tjerë, provuan shtypjen dhe shfrytëzimin e rëndë të pushtuesve italianë. Kjo bëri të shtohet gjithnjë e më shumë urrejtja kundër tyre. Për rrjedhojë, shtohet edhe qëndresa ndaj tyre kudo që ndodheshin, duke marrë pjesë aktive në protesta e demonstrata që organizoheshin kundër pushtuesve fashistë italianë.

5 Maji, "Dita e Dëshmorëve të Atdheut"

NË KALLARAT PËRKUJTOHEN DHE NDEROHEN DËSHMORËT

Edhe banorët e Kallarait, kujtojnë dëshmorët e fshatit që dhanë jetën për çlirimin e vendit. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i fshatit z. Lefter Qejvanaj. Me këtë rast, pranë lapidarit, në emër të Këshillit të fshatit, Organizatës së Dëshmorëve dhe të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe familjeve të dëshmorëve u vendosën kurora e buqeta me lule. Vlerësim e Mirënjohje gjithë atyre që dhanë jetën dhe kontributin për lirinë e atdheut! Mirënjohje dhe gjithë bashkëfshatarëve në Kallarat që sot morën pjesë në këtë përkujtim. Në fund të kësaj ceremonie u shtrua një drekë e përbashkët e sponsorizuar nga z. Dhimitër Kapaj.

Rënë në luftë ndaj andartëve grekë më 1914.

1. Murat Avdul Demiraj
2. Dervish Sali Maçaj
3. Ramadan Muhamet Hoxhaj
4. Çelo Mustafa Boshaj
5. Hyso Balil Xhaferaj

Rënë në luftë kundër fashistëve Italianë më 1920.

1. Xhevair Musa Gollosaj

Rënë në Luftën Nacionalçlirimtare kundër nazifashistëve

1. Mumin Selam Bajramaj (Hero i Popullit)
2. Adil Lame Petanaj
3. Ali Birçe Ribaj
4. Ali Sulo Memushaj
5. Avdul Demir Demiraj
6. Ferik Miftar Gollosaj
7. Ferik Teslim Strataj
8. Filo Fasli Breshanaj
9. Hamdi Shuaip Sheraj
10. Hamza Malo Qejvanaj
11. Hasan Laze Qejvanaj
12. Islam Tasim Janaj
13. Lilo Dine Habilaj
14. Nelo Nazer Hysaj
15. Nexhip Shuaip Sheraj
16. Nuredin Selam Breshanaj
17. Ormen Boro Ribaj
18. Shuko Ramo Karabollaj
19. Tare Çelo Gjonaj
20. Zyber Shuaip Sheraj

Rënë për mbrojtjen e demokracisë

1. Elham Sulejman Sheraj (Elezi)
- Qoftë i paharruar kujtimi i tyre!



Historia dhe tradita

JO PAKICË GREKE NË HIMARË, PO HIMARJOTË ME SHTETËSI SHQIPTARE DHE GREKE



PROF. DR. RAMI MEMUSHAJ

Përsëri Athina zyrtare, duke marrë shkas nga ndalimi i një shqiptari të vetëshpallur grek, ripërsëriti tezën e vjetër se Himara është greke. Ministri i Jashtëm Dendias dhe vetë kryeministri Micotaqis kërcënuan se, pa respektimin e të drejtave të minoritetit grek, Shqipëria do t'i ketë të mbyllura dyert e BE-së.

Po a ka popullsi greke në Himarë? Kësaj pyetjeje historianët dhe studiuesit shqiptarë i kanë dhënë përgjigje me një varg veprash, ndër të cilat po përmendim "Historia e Himarës (2002) të studiuesit himarjot Aleko Rrapo, "Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve" (2005) të akad. Kristo Frashërit, "Ipet e Iperit - Himariotët" (2004) të Foto Bixhilit etj. Edhe autori i këtij shkrimi i është përgjigjur kësaj pyetjeje në librin "Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike" (2004), si dhe në artikujt të botuar në shtypin shkencor e të përditshëm.

Siç dihet, ndër kriteret dalluese për një pakicë etnike janë territori, historia dhe tradita e saj kulturore. Nga pikëpamja e territorit, treva e Himarës është larg kufirit grek dhe në brendësi të tokave shqiptare, dmth. nuk ka lidhje territoriale me Greqinë, gjë që përbën një kusht që një popullsi të quhet pakicë etnike. Nga pikëpamja historike, kjo trevë ka qenë pjesë e Kaonisë së lashtë dhe historia nuk njihet koloni greke në bregdetin shqiptar të Jonit. Himara ka qenë e banuar nga ilirë epirotë dhe pasardhësit e tyre arbër e më pas shqiptarë dhe jo nga kolonë grekë, sikundër mëtojnë grekomanët e Himarës.

Duke filluar nga fundi i shek. XV e deri në shek. XVIII, Himarë është quajtur krahina në jug të Vlorës dhe në perëndim të Vjosës e të Drinos, pra Labëria e sotme. Historiani grek Konstantin Sathas, duke shkruar për kryengritjen e Kostandin Muzakës të vitit 1481, flet për «malet e Himarës» dhe për «popujt e asaj malësie që janë më shumë se 50 fshatra». Dhe kjo krahinë ka qenë e banuar nga shqiptarë. Kronisti mesjetar Stefano Manjo (Magno), kur flet për kryengritjen e Himarës të vitit 1484, i cilëson himarjotët si shqiptarë (Queli di Zimera, populi Albanesi). Po ky kronist thotë se në veprimet luftarake të venedikasve kundër turqve në grykën e Vjosës më 1501 "morën pjesë edhe shqiptarët himarjotë (albanesi zimarioti). Më qartë se ç'kuptohej me Himarë e tregon udhëtari frëng Denis Possot, i cili në shënimet e veta të vitit 1532 shkruan se provinca e Shqipërisë është e ndarë në tri pjesë: pjesa e parë nën zotërimin e venedikasve, e dyta është nën pushtimin e sulltanit dhe "e treta është në zotërimin e shqiptarëve", që "mbahen në një vend e në një pjesë të Shqipërisë që tani quhet Himarë".

Me islamizimin e fshatrave të hinterlandit (të prapamalit), që u përmbyll aty nga fundi i shek. të 18-të, shtrirja e emrit Himarë erdhi e u rrudh duke u përdorur vetëm për 7 fshatrat e Bregut të Sipërm, kurse e tërë krahina në jug të Vlorës dhe midis Jonit e Vjosës e Drinos u quajt Labëri.

Historia e lashtë dhe e re e Himarës është e lidhur me historinë e Labërisë. Në Himarë janë bërë kuvendet nga më 1577 e 1593 u janë dërguar letra për ndihmë papëve të Romës dhe



më 1759 careshës së Ruisë, në të cilat ata u drejtohen në emër të klerikëve e laikëve të 50 fshatrave "prej Himare, dmth. prej Epirit të shqiptarëve".

Nga pikëpamja administrative, në regjistrin osman të vitit 1431 këto 7 fshatra dalin si pjesë e nahijes së Himarës, që lidhej me vilajetin e Gjirokastrës. Në riorganizimet e mëvonshme, Himara del herë si pjesë e kazasë së Kurveleshit e herë si kaza e sanxhakut të Delvinës. Nga pikëpamja fetare, qyteza e Himarës ka qenë qendër peshkopate, e varur në fillim nga mitropolia e Nikopojës (Prevezës), prej vitit 1019 e deri më 1767 nga kryepeshkopata e Ohrit dhe nga ajo kohë e këtej e varur nga mitropolia e Gjirokastrës. Pra, asnjëherë peshkopata e Himarës nuk ka qenë e lidhur me kishën greke, pavarësisht se peshkopët dhe priftërinjtë grekë të Korfuzit dhe të Janinës janë përzier në punët e kishës shqiptare të Himarës.

Edhe etnografikisht fshatrat e Himarës i përkasin njësisë së madhe etnografike të Labërisë. Himarjotët i bashkojnë me Labërinë fustanella dhe veshjet e tjera tradicionale, kënga polifonike dhe vajtimi shqip i të vdekurve, ritet e njëjta të lindjes, të martesës dhe të vdekjes, doket dhe gjuha shqipe.

Ajo që i ndan tri fshatrat e Himarës (qytetin e Himarës, Dhërmiu dhe Palasa) nga pjesa tjetër e Himarës dhe nga gjithë Labëria, është se janë dygjuhëse, greqisht- e shqipfolëse. Si argument në mbrojtje të tezës se himarjotët janë grekë, sille pikërisht fakti që këto tri fshatra flasin greqisht. Sipas përkrahësve të kësaj teze, edhe Iliazi, Vunoi, Qeparoi e Kudhësi kanë qenë greqishtfolëse, por e kanë humbur greqishten nga trysnia e gjuhës shqipe!

Mirëpo dëshmitë historike tregojnë të

kundërtën. Në një libër italisht të botuar në Ferrara më 1598, thuhet se «himarjotët flasin shqip». Vetë himarjotët në letrën dërguar nga Himara careshës së Ruisë, thonë se "flasim shqip, atë gjuhë që flitet në Shqipërinë e afërme dhe në Bosnjë, po në vende të ndryshme të gjithë të mësuarit flasin greqisht e familjet më të shquara përdorin edhe italishten". Milingeri, doktori i Bajronit, shkruan se 200 himarjotët që shkuan në ndihmë të revolucionit grek, "nuk dinin asnjë fjalë greqisht".

Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti se tri fshatrat e mësipërme kanë qenë dygjuhëse. Për këtë ka gjithashtu dëshmi historike. Kështu, në një memorial të vitit 1500 që ruhet në bibliotekën e Firences, të botuar nga historiani rumun Nikolae Jorga, për himarjotët thuhet se "banorët e këtij vendi janë ilirë që tani quhen shqiptarë, megjithëse përdorin edhe gjuhën greke, por në mënyrë shumë të huaj". Misionari Filoteo Zasi, që shërbeu në Himarë, në një relacion të bërë rreth vitit 1700 shkruan se «gjuhët e domosdoshme për këta popuj janë greqishtja dhe shqipja. Martin Liku, konsulli britanik pranë Ali Pashës thotë se "gratë himarjote flasin vetëm shqip, ndërsa burrat përveç shqipes dinë ose italisht, ose greqisht". Gjysh Sheldija, 100 vjet më parë, duke karakterizuar gjendjen gjuhësore të kësaj krahine, shkruan se: "edhe këta të fundit (fshatrat shqipfolëse - R. M.) e dinjë greqishten, sikurse edhe ata të parët (fshatrat greqishtfolëse) shqypen".

Pra, në fshatrat e Himarës nuk ka pasur kurrë njëgjuhësi në greqisht. Aty elementi vetëm shqipfolës dhe elementi shqip e greqishtfolës banon në dy enklava - njëra enklava dygjuhëse e Himarës dhe tjetra e Dhërmi-Palases, të ndara prej bashkësisë shqipfolëse të Vuno-Iljazit dhe të rrethuara nga të gjitha anët prej shqipfolësish

njëgjuhës. Duke u nisur nga kjo gjendje e gjërave, nuk mund të pranohet kurrsesi që Himara si krahinë përbën një pakicë gjuhësore.

Për të provuar gjuhësisht që, edhe pse flasin greqisht, këto tri fshatra janë shqiptare, në një studim të posaçëm tonin jemi ndalur vetëm te patronimet (llagapet e njerëzve). Nga studimi që u kemi bërë këtyre të fundit, na ka dalë se numri i emrave të huaj të familjeve të Himarës nuk është i madh. Më 1583, vetëm shtatë emra familjesh janë fjalë greke dhe pesë turke; më 1791, vetëm pesë nga 59; dhe, më 2003, rreth 40 llagape greke, dy hebreje, dy prej gjuhëve romane dhe tetë turke, pra diçka më pak se 7 për qind e llagapeve të sotme të krahinës. Dhe pesha specifike e elementit të huaj në patroniminë e kësaj treve ka mbetur pothuajse e pandryshuar dhe e papërfillshme në shekuj.

Patronime greke që hasen në trevën e Himarës janë: Aleksi, Anagnosti, Andoni, Andrea, Apostoli, Athanasi, Dhimaqi, Dhimitraqi, Dhimolea, Foto, Ilija, Harito, Janaqi, Janila, Jorjani, Jorgo, Jorgonllu, Jovani, Karali, Konomi, Kristofori, Llambro, Llanduri, Llazari, Manoli, Marko, Martini, Mihali, Mihallo, Nikolla, Odhisea, Panajoti, Panajoti, Pavlo, Proto, Polimeri, Paskali, Pavli, Stavro, Stefani, Stimaqi, Stolaj, Triandafilu, Trolaj Thanasi, Theodhori/Todori, Vasili e ndonjë tjetër.

Këto llagape me prejardhje greke nuk janë të bartësve grekë, po emra të botës së krishterë greko-bizantine, dmth. të tilla që kanë hyrë nga ndikimi i kishës ortodokse, e cila liturgjitë dhe shërbesat fetare i kryente në gjuhën greke. Shumë nga këto llagape hasen edhe në treva të brendshme të vendit, ku nuk mund të bëhet kurrsesi fjalë për prani të popullsisë greke. Kjo do të thotë se prania e llagapeve të tilla në Himarë nuk mund të merret si argument që bartësit e tyre nuk janë shqiptarë, po grekë.

Lidhur me përkatësinë etnike të familjeve të qytezës së Himarës, në librin "Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike", kemi thënë se aty "me prejardhje greke janë Trolajt; Stolajt, të ardhur nga Dropulli; Konomajt (jo Konomët), të ardhur nga Sopiku; dhe Zisajt, të ardhur nga Pogoni". Por, nga hetimet e mëvonshme, na ka dalë se Zisajt e Konomajt janë familje shqiptare nga Sopoti, Stolajt të ardhur nga Rrëzoma dhe Trolajt të ardhur nga Vithkuqi.

Për ta përmbyllur, të flasësh për pakicë greke në Himarë duke u nisur nga ajo që dhjetëra himarjotë që banojnë aty kanë edhe pasaporta greke, është një e pavërtetë e madhe. Shqiptarë me pasaporta greke mund të ketë në gjithë Shqipërinë, por ata nuk formojnë dot një minoritet etnik grek, ashtu sikundër nuk formojnë një minoritet etnik as disa qindra mijë emigrantë shqiptarë në Greqi.

Mendojmë se është detyra e politikës shqiptare të mos bëjë kompromise dhe lëshime me termat, por t'u tregojë me fakte homologëve grekë se Himara nuk është minoritet dhe se këmbëngulja e këtyre për të kundërtën dhe trysnitë politike ndaj vendit tonë për këtë temë janë shfaqje të nacionalizmit shoven, që përbëjnë një shkelje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë.

KUJTESË PËR TAKIMIN E BREZAVE NË KALLARAT MË 12 GUSHT 2023

Ashtu siç ju kemi bërë me dije më parë, Kryesia e shoqatës “Kallarat” ka vendosur që më 12 gusht 2023, ditë e shtunë ora 19:00, në Kallarat të organizon “Takimin e Brezave”, një veprimtari e përvitshme shumë e mirëpritur nga të gjithë kallaratasit. Mos harroni të planifikoni lejet, sidomos emigrantët. Zhvillimi i këtij takimi kërkon organizim, por edhe mbështetje financiare. Është i mirëpritur kushdo, person i vetëm ose grup personash, të kontribuojë me lekë/euro/dollarë ose me kontribute të tjera materiale për sa më poshtë:

1. Sponsorizim për orkestrën dhe këngëtarët.
2. Sponsorizim për zbulimin e ndriçimin e qendrës së fshatit dhe të hyrjes nga të dy anët (banderola, parulla, drita, projektorë, etj).
3. Sponsorizim për filmimin, bërjen e fotove dhe transmetimin e një kronike televizive të veprimtarisë në një nga televizionet lokale të Vlorës.
4. Ngritjen e grupit polifonik të fshatit.

Të gjitha sponsorizimet do të menaxhohen nga një komision gjithëpërfshirës që do të ngrejë së shpejti kryesia e shoqatës me qendër në Vlorë.

Të gjithë së bashku mund të bëjmë gjëra të mira, që t’ia ngremë lavdinë vendlindjes, origjinës të gjyshërve e prindërve tanë, Kallaratis.

*Faleminderit për mirëkuptimin!
Kryesia e Shoqatës “Kallarat”*



TAKIM BREZASH “NA BASHKON MBIEMRI GJONBRATAJ”

Ashtu siç është bërë traditë organizimi i “Takimit të Brezave” në shkallë fshati, më 11 qershor 2023, vëllazëria Gjonbrataj zhvilloi në Kallarat një takim brezash, titulluar “Na bashkon mbiemri Gjonbrataj”. Ky takim i zhvilluar në Kallarat në vendlindjen e të parëve të kësaj vëllazërie, ku merrnin pjesë fëmijët, nuset, nipërit/stërnipërit, mbesat/stërmbesat e Muços, të Sadikut, Tahirit, Kaleses e Sheleges (fëmijët e Xhevit e Hatixhe Gjonbrataj), që jetojnë në Kallarat dhe të ardhur nga Tirana e Vlora, pati si qëllim çmalljen me njëri-tjetrin, njohjen nga brezi i ri të fshatit të vendlindjes së prindërve ose të vëndit të origjinës së tyre.

Në këtë takim morën pjesë nga brezi më i vjetër, 92-vjeçarja Sulltana Gjonbrataj e deri te brezi më i ri fare.

Nëpërmjet një panorame, bërë nga njëri prej anëtarëve të kësaj vëllazërisë, anëtarët e saj, sidomos më të rinjtë, u njohën pak a shumë me historinë e Kallaratis, në mënyrë të veçantë me historinë e brezave të parë të Gjonbratajve. U njohën me sakrificat e gjyshes Hatixhesë, e cila, pasi bashkëshorti, Xhevit i vdiq i ri në vitin 1926, u detyrua t’i rriste e t’i martonte fëmijët e vet me sakrificat të mëdha deri sa ata krijuan familjet e tyre. U njohën me jetën e aktivitetin familjar e kontributin shoqëror të prindërve e gjyshërve/gjysheve të tyre, dhënë jo vetëm në Kallarat, por kudo ku ata punuan.

Të gjithë në këtë takim sollën kujtime e bënë përshtetje duke vlerësuar lart kontributin e prindërve për rritjen, edukimin dhe shkollimin e tyre, për familjen e Muços e Xhikos në Kallarat; Sadikut e Emnesë në Gramsh e Elbasan; Tahirit e Sulltanës në Tiranë e në Vlorë; Kaleses në Bolenë; e Xhaferit e Sheleges në Tiranë, dyert e shtëpive të të cilëve ishin kurdoherë hapur jo vetëm për Gjonbratajt, por edhe për bashkëfshatarët e tjerë.

Sulltana Gjonbrataj, si më e moshuara e Gjonbratajve (92 vjeçe), veterane e Luftës Antifashiste dhe ish-deputete e Kuvendit Popullor në dy legjislatura, në fjalën e saj, falënderoi të gjithë nipërit e mbesat për këtë organizim të shkëlqyer duke dhënë



këtë porosi: “Duajeni njëri-tjetrin në të mira e gëzime, por edhe në fatkeqësi, respektoni prindërit, të afërmit dhe më të moshuarit, duajeni vendlindjen dhe origjinën e të parëve Tuaj, sidomos brezi e ri! Mund të punoni e jetoni edhe jashtë vendit, por mos harroni vendin Tuaj, Shqipërinë, duajeni atë dhe flamurin kuq e zi”!

E veçanta për ata që vinin për herë të parë, ishte rruga e Lumit të Vlorës dhe natyra e bukur plot gjelbërimi.

Takimi kaloi mjaft bukur, nën tingujt e muzikës popullore e shërbimin me kulturë të stafit të klubit të Zeqo Hoxhaj me Ergesin në krye e Restorant “Sazani” dhe fotove para lapidarit. Një falënderim të veçantë për DJ, Silvin dhe kameramanin Besi nga Vlora. Ky rast e ky organizim le të jetë si nxitje edhe për fiset e tjera në Kallarat.



SARA SPARTAK MEMUSHAJ STUDENTJA QË SHKËLQEN NË ATHINË

Kemi folur për mjaft të rinj e të reja kallaratase, që me rezultatet e tyre në shkollë, por edhe në fushën e kërkimeve shkencore, po bëjnë emër në institucionet më prestigjioze kombëtare, madje edhe ndërkombëtare.

Një prej tyre është edhe Sara Spartak Memushaj, mbesa e Balil Memushajt në Vlorë.

Sara ka lindur në 2 prill 1999 në Athinë, me prindër Spartak e Rudina Memushaj. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Zografo të Athinës me rezultate të shkëlqyera, duke marrë fletëlavdërimi nga shkolla dhe Ministria greke e Arsimit. Edhe pse e lindur në Athinë, ajo për asnjë çast nuk e mohon origjinën shqiptare, nuk e mohon Vlorën, vendlindjen e prindërve, nuk e mohon Kallaratin, origjinën e babait të saj, përkundrazi ndihet krenare dhe e quan për nder.

Mbasi mbaroi shkollën e mesme me nota shumë të mira, Sara fitoi të drejtën e studimit për Inxhinieri Mekanike në Athinë, ku aktualisht është në vitin e pestë. Ajo që bie në sy, është pasioni i saj për shkencën. Në vitin 2021 Sara u mor me një studim mbi energjinë dhe aerodinamikën dhe, mbasi e dërgoi atë në Universitetin e Stambollit dhe në Qendrën Bërthamore në Gjenevë (CERN), menjëherë, mori ftesë nga të dyja institucionet shkencore. Por Sara vendosi të zgjedhë CERN-in dhe që nga shkurti i 2023-shit është e punësuar si studente ekselente pranë Qendrës Evropiane për Kërkime Bërthamore në Gjenevë, Zvicër dhe njëkohësisht vijon bërjen e diplomës mbi aerodinamikën dhe energjinë.

Gjithashtu, Sara ka pasur edhe më parë angazhime të tjera shkencore. Kështu, në vitin 2019 ka fituar konkursin dhe ka punuar si inxhinire në EIDAP (Shërbimi i Ujësjetës Ambelokipos Athinë). Në 2021 ka shkuar për specializim në Universitetin Inxhinierik në Lituani.

Studimet dhe angazhimet e saj shkencore nuk kanë fund. Pasioni dhe vullneti i saj për të arritur majat e shkencës janë për t'u admiruar.

Të rinj të tillë, studentë me ambicie të pashtershme drejt së pakapshmes, drejt së panjohurës në shërbim të njerëzimit, pavarësisht se në cilin vend e shtet ndodhen, në cilin universitet studiojnë, përveçse janë krenaria e familjes, janë dhe mbeten edhe krenaria e vendit të origjinës së tyre, Kallaratis.

Kryesia e shoqatës "Kallاراتi" i uron Sarës suksese në rrugën e shkencës!



Sara ka lindur në 2 prill 1999 në Athinë, me prindër Spartak e Rudina Memushaj. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Zografo të Athinës me rezultate të shkëlqyera, duke marrë fletëlavdërimi nga shkolla dhe Ministria greke e Arsimit. Edhe pse e lindur në Athinë, ajo për asnjë çast nuk e mohon origjinën shqiptare, nuk e mohon Vlorën, vendlindjen e prindërve, nuk e mohon Kallaratin, origjinën e babait të saj, përkundrazi ndihet krenare dhe e quan për nder.

NË FESTIVALIN E KATËRT "NETËT E BEJKËS SË BARDHË", KRAHAS SHUMË ÇMIMEVE ME EMRAT E PERSONALITEVE TË SHQUARA TË KËNGËS LABE, JEPET EDHE DIPLOMA "HYSO XHAFERAJ"

Nga data 9-10 qershor 2023 në Pilur, në kryeqendrën e Polifonisë Labe, u zhvillua Festivali i Katërt "Netët e Bejkës së Bardhë", organizuar nga Bashkia e Himarës, nën drejtimin e drejtorit të Festivalit, zotit Kristo Çipa "Mjeshtër i Madh".

Në çmimet e dhëna grupeve dhe interpretuesve më të mirë të festivalit, si: Çmimi "Lefter Çipa", "Feti Brahimi", "Maliq Lila", "Nertesi Asllani" etj., nga organizatorët ishte menduar edhe dhënia e Diplomës "Hysa Xhaferaj", diplomë të cilën juria e përbërë nga: profesor-maestro Zhani Ciko, zonja Afërdita Onuzi (Mjeshtre e Madhe), z. Naxhi Kasotuhu (Mjeshtër i Madh), z. Arben Bllaci (poet, publicist) ia dhanë "Mjeshtër të Madh" Vendim Kapaj si "Hedhësi më i mirë këngës polifonike në festivalin e katërt "Netët e Bejkës së Bardhë", rol të cilin e bënte në mënyrën më të përsosur biri i fshatit tonë, "Bilbili i Labërisë", Hysua ynë.

Falënderojmë organizatorët e festivalit, jurinë dhe në mënyrë të veçantë "Mjeshtër të Madh" Kristo Çipën për këtë vlerësim, por edhe në tërësi për zhvillimin e Festivalit dhe mbajtjen ndezur në shpirtin tonë të këngës polifonike labe, vënçe siç e kemi quajtur, apo "Fosforinën Labe", siç e quante Poeti i Madh i Labërisë Lefter Çipa "Nderi i Kombit".



Në çmimet e dhëna grupeve dhe interpretuesve më të mirë të festivalit, si: Çmimi "Lefter Çipa", "Feti Brahimi", "Maliq Lila", "Nertesi Asllani" etj., nga organizatorët ishte menduar edhe dhënia e Diplomës "Hysa Xhaferaj", diplomë të cilën juria e përbërë nga: profesor-maestro Zhani Ciko, zonja Afërdita Onuzi (Mjeshtre e Madhe), z. Naxhi Kasotuhu (Mjeshtër i Madh), z. Arben Bllaci (poet, publicist) ia dhanë "Mjeshtër të Madh" Vendim Kapaj si "Hedhësi më i mirë këngës polifonike në festivalin e katërt "Netët e Bejkës së Bardhë", rol të cilin e bënte në mënyrën më të përsosur biri i fshatit tonë, "Bilbili i Labërisë", Hysua ynë.

HUMOR: TË PISH A TË MOS PISH, KJO ËSHTË ÇËSHTJA?!



(Ngjarje e vërtetë botuar në një revistë ruse në vitet '70 – rrëfeu Hiqmet Meçaj)

Ky qe 101 vjeç, babai ishte 121. Gazetari që gjurmonte rastet e jetëgjatësisë, u informua për një bari që jetonte në majat e larta të Pakistanit. Shkoi t'i bënte intervistë për të zbuluar shkaqet e jetëgjatësisë, edhe pse bari vazhonte të ruante bagëtitë si djalë i ri. E pyeti për shkaqet

e kësaj gjendjeje shumë të mirë shëndetësore, megjithëse i kishte kaluar 100 vjeç? Bariu i tha: "kam punuar që 10 vjeç, nuk kam abuzuar me alkool, jam vegjetarian, dhe nuk kam abuzuar me gratë, por kam vetëm gruan time". Tek dëgjonte të moshuarin, gazetari shkroi në billok se një jetë e gjatë vjen si rezultat i një jete të pastër plot punë dhe aktivitet. Në këtë kohë u dëgjua një britmë e madhe, u rrokullisën ca gurë dhe plaku njëqindcavjeçar u lebetit e i tha gazetarit: "Ika të fshihem se po vjen babai i dehur dhe, çdo natë kur më gjen këtu, më rreh". Gazetari e pyeti: "Sa vjeç qenka babai yt?" "121, – iu përgjigj bariu". Atëherë gazetari e fshiu atë që kishte shkruar më parë për jetëgjatësinë.



ATDHEU IM ME DY HISTORI DHE ASNJË TË VËRTETË


Poezi nga Petrit Qejvani (ndarë nga jeta)

Atdheu im fitimtar dhe i mundur,
hero dhe tradhtar
patriot dhe i shitur
lirimbrojtës dhe mercenar,
atdheu im me një histori të shkruar nga shqiptarët
dhe një tjetër të shkruar nga të huajt (normale)
atdheu im me dy histori edhe prej vet' shqiptarëve (anormale)
një histori e fitimtarëve dhe një histori e të mundurve
kur të mundurit kthehen në fitimtarë,

fitimtarët kthehen në të mundur.
Atëherë rrëzohen statujat e heronjve dhe vendosen ato të tradhtarëve.
Pastaj e kundërta.
Atdheu im me dy histori dhe asnjë të vërtetë.
Atdheu im me dy palë heronj
E me dy palë tradhtarë,
Me heronj tradhtarë



Dhe tradhtarë heronj.
Atdheu im paradoksal
që më dhemb deri në palcë
që ke ecur gjithnjë me një këmbë e një patericë,
kur do t'i kemi të njëjtë heronjtë dhe të njëjtë tradhtarët?



NJË VIZITË TE EKSPOZITA "PATRIOT" E ARTISTIT KALLARATAS, SAIMIR STRATI NË TIRANË

Në muajin prill të këtij viti, piktori Saimir Strati, fitues i njëmbëdhjetë titujve "Guinness", të "Kalaja e Tiranës" hapi ekspozitën e titulluar "Patriot". Vizitorë të shumtë, vendas e të huaj, dashamirës të artit e të kulturës (por jo zyrtarë), shënime në librin e vizitorëve, foto e intervista të shumta – siç shprehet vetë Saimiri – e kanë shoqëruar këtë ekspozitë të tijen. Në këtë ekspozitë ishin ekspozuar 20 vepra arti, në të cilat tematika ishte kryesisht kombëtare për të nxjerrë në pah vlerat e Shqipërisë.

Në emër të shoqatës "Kallarati", disa bashkëfshatërë me banim në Tiranë lanë në librin e përshypjeve shënimin: "Urime artistit Saimir Strati, fitues i njëmbëdhjetë çmimeve "Guinness", me të cilat ka bërë krenarë jo vetëm shqiptarët, por edhe fshatin e vendlindjes së prindërve të tij, Kallaratin. Ec ngado Saimir, por Kallarati mos e harro!"

Në një bisedë me Saimirin, ai shprehet se, në planet e tij të ardhshme, ka edhe diçka për Kallaratin, vendlindjen e prindërve të tij, por tani për tani, le të ngelet si surprizë derisa të vijë momenti i duhur.



NË SHTËPINË E SHPIRTIT

Poezi nga Lela Qejvani

*Në shtëpinë e shpirtit,
i ruaj të gjitha,
Kujtimet e jetës
të ëmbla e të hidhura.
Si muze të vogël e kam zburuar,
Në një tavolinë,
zemra kam pikturuar,
Zemra që kanë ikur
dhe janë transformuar.
Zemra që jetojnë,
bërë të ftohta akull,
Zemra të ngrohta,
në to zien gjaku.
Lart tek bufeja pikturova puthje
Dhe ca përqaftime atje tej më tutje.
Tek shtëpia e zemrës,
se ç'më zuri nata
duke pikturuar sytë e tu të kaltër.
Se ç'donin të thoshnin,
aspak s'i kuptova.
Mbi ta ishin hedhur ca fije të arta.
Në shtëpinë e shpirtit ka shumë
vjetërsira
Ca janë me shumë vlerë,
dhe ca të pështira...*

Vlorë, më 13 janar 2019

Humor: "Pulë e zezë pa patate"

Nga Arben Meçaj

Pak humor në ditën e fundit të vitit, që ta përcjellim duke qeshur, me urimin që edhe 2024-a të na sjellë sa më shumë të qeshura të tjera! Natyrisht, duke qënë edhe dita ku tavolinat mbushen me pjata nga më të shijshmet, po vendos një recetë gatimi për vajzat dhe nusët e reja. Kuptohet, vetëm për ato që nuk kanë shumë përvojë në zanatin e bukur të gatimit.

Receta quhet "Pulë e zezë pa patate"
Lajeni pulën mirë e mirë në ujë.

Hiqni më parë unaza, byzlykë, orë dore, pinsing, vëthë, sepse mund t'u humbasin e do ia hidhni fajin pulës.

Përdorni ujë të vakët, që të mos u çahet lëkura e gishtave.

Përdorni dorashka për të mos rrezikuar smaltin e thonjve.

Shani, me libër shtëpie, atë gocën e dyqanit që nuk e ka pastruar mirë pulën.

Merrni një tavë (ajo prej metali me formë drejtkëndëshi)

Shrtijeni pulën në tavë. Me bark a me kuriz, nuk ka rëndësi pozicioni. Do e piqni, nuk do bëni seks!

Kriposeni pulën duke pasur kujdes se është kripë dhe jo pudër.

Bëni 17 foto dhe 4 selfie me pulën.

Dërgoni fotot në instagram, whatsapp, facebook. Mos harroni video në tiktok.

Shikoni fotot dhe selfiet sa like kanë marrë. Kujtohuni (nga fotot), se rreth e rrotull pulës mungon diçka. Keni harruar të blini patatet ... herën tjetër... nuk ka problem.

Vendoseni tavën në furrë të nxehtë 220°, për rreth 1/2 ore.


Futuni në Facebook.

Hapi derën fqinjës kur të trokasë për të pyetur se ç'është kjo erë e djegur nëpër shkallë. Fik furrën dhe hap dritaren.

Shaj fqinjën që nuk shikon punët e saja, por fut hundët atje ku s'duhet.

Porosit pulë të pjekur. Shaj ata të rostitçerisë që i kanë ngritur çmimet përsëri. Qaj nga inati.

Gëzuar të gjithëve, mikesha dhe miq!



SPORT: ÇLIRM HYSI, MODELI I NJË SPORTISTI SHËMBULLOR DHE I NJË DREJTUESI TË AFTË

Çlirim Xhafer Hysi (Xhaferaj), ish-futbollist i ekipeve të 17 Nëntorit e të Dinamos, ish-drejtues i klubit "Dinamo" dhe "17 Nëntori" të Tiranës dhe mësues i edukimit fizik

Çlirimi lindi më 1 janar 1945 në Kallarat të rrethit të Vlorës, në një familje me ndjenja të theksuara atdhetare e liridashëse. Prindërit e tij, Xhaferi dhe Shelegia, me shumë mundime e sakrificë rritën, arsimuan dhe edukuan fëmijët e tyre me ndjenjën e dashurisë për njerëzit, të afërmit e vendlindjen, veti e cilësi këto që te Çlirimi u bënë pjesë e pandarë e jetës së tij.

Pas kryerjes së shkollës 7-vjeçare në Tiranë, ndoqi Teknikumin e Fizkulturës po në Tiranë, të cilin e përfundoi në vitin 1963. Nga viti 1963 deri në vitin 1966 përfundon arsimin e lartë, Institutin e Kulturës Fizike dhe Sporteve "Vojo Kushi". Më vonë përfundon edhe Fakultetin Juridik në Universitetin e Tiranës.

Pasioni i tij ishte futbolli, prandaj gjithë jetën ia kushtoi atij, fillimisht si sportist dhe më vonë drejtues klubi. Që në vogëli, Çlirimi do të spikaste si futbollist, duke luajtur bukur në shkollë, por edhe në lagje dhe dalëngadalë do të shfaqej si një talent e do të tërhiqte vëmendjen e trajnerëve të asaj kohe. Gjatë kohës së shkollës 7-vjeçare u aktivizua për disa vjet me radhë në përbërje të ekipit të futbollit të Pallatit të Pionierëve në Tiranë, ku spikatin aftësi të rralla të një mesfushori të ardhshëm.

Në vitin 1961 aktivizohet në Pallatin e Pionierëve me ekipin e të rinjve, në rolin e mesfushorit; më vonë me ekipin e të rinjve të Vllaznisë së Shkodrës. Aktivizimi me këtë ekip bëri që të tërhiqte vëmendjen e skuadrës së "17 Nëntorit" dhe me ndërhyrjen e tyre kthehet në Tiranë për të vazhduar Teknikumin e Fizkulturës; në moshën 17-vjeçare aktivizohet në ekipin e futbollit të të rriturve të "17 Nëntorit", në rolin e mesfushorit dhe gjatë këtij viti fiton edhe Kupën e Republikës.

Në vitin 1964 kalon pranë skuadrës mjaft të njohur e me tradita, "Dinamos", ku do të luajë deri në vitin 1974, vit në të cilin për arsye moshe do ta lërë edhe sportin e futbollit, të cilin e dashuronte aq shumë dhe të cilin i faliti atij rininë. Vitet më të bukura të karrierës së tij sportive mbeten ato me ekipin e "Dinamos", si një mesfushor shumë i suksesshëm, përkrah mjaft futbollistëve të dëgjuar të asaj kohe. Ka luajtur në disa ndeshje ndërkombëtare në rang klubesh në Kupat e Evropës. Në karrierën e tij sportive ka shënuar mjaft gola dhe ka dhënë kontributin e tij në fitimin e disa Kampionateve dhe Kupave të Republikës,



fillimisht në përbërje të ekipit të "17 Nëntorit" dhe më vonë të "Dinamos".

Çlirimi ishte modeli i një sportisti me kulturë. Cilësi të karakterit të tij ishin korrektësia, ndërgjegjshmëria, dashuria dhe respekti për shokët, drejtuesit e trajnerët dhe, mbi të gjitha, për sportdashësit, të cilët i jepnin duartrokitje tepër të zjarra. Vërtet që në vitin 1974, e la fushën e blertë, por ai kurrë nuk iu nda sportit, jo më në rolin e lojtarit të skuadrës, po duke marrë mbi supe detyra dhe përgjegjësi edhe më të mëdha si drejtues i dy klubeve më kryesore dhe më me peshë në Shqipëri, në të "Dinamos" dhe të "17 Nëntorit". Në rezultatet e larta që këto dy klube kanë arritur në sportin e futbollit, volejbollit, qitjes, basketbollit atletikës gjatë viteve 1976–1990, patjetër që pjesë e këtyre trofeve është rezultat edhe i punës drejtuese e organizuese e Çlirimit.

Për aftësitë dhe talentin e tij si sportist, por edhe si drejtues i sportit në përgjithësi, Çlirimi ka marrë një sërë vlerësimesh dhe dekoratash nga Kuvendi Popullor dhe nga institucionet

sportive në vend.

Çlirimi, përveçse sportist shembullor, ishte edhe një bashkëshort, prind, vëlla dhe shok i rrallë. Ai ishte njeri i qetë e paqësor, i palodhur e i pakursyer dhe do të kishte kontribuar akoma në familje e në shoqëri. Por sëmundja e rëndë që iu shfaq vitet e fundit, me gjithë përpjekjet e stërmundimin e bashkëshortes dhe të djemve, e ndau atë para kohe nga gjiri i familjes dhe i shoqërisë, duke lënë vetëm shoqen e jetës, Margaritën, dhe dy djemtë, Arditin dhe Gjergjin, të cilët i donte aq shumë, dhe duke pikëlluar e hidhëruar pa masë vëllezërit, nipërit e mbesat, si dhe shokët e miqtë e tij.

Çlirimi u nda para kohe nga jeta në datën 10 nëntor 2016, pas një sëmundje të rëndë e të gjatë, por ai do të ngelet në kujtesën e kujtdo që e njohu dhe punoi me të, si modeli i një sportisti dhe drejtuesi model për brezat e rinj të sportit në përgjithësi dhe të futbollit në veçanti. I tillë do të kujtohet edhe nga bashkëfshatarët e tij kallaratas.

Besnik Gjonbrataj



POEZI NGA
RIZA MEMUSHAJ

*Socializmin e provuam,
Po nuk qe si tha Lenini
S'hëngërm me lugë floriri,
Por me lugë alumini.*

*Bulmeti i racionuar,
Mishi jepej me recetë,
Plot gjëra kanë munguar,
Por gjumin bënim të qetë.*

*Dyert kanatë natë e ditë
Dritaret nuk kishin zgarë
Kush kapej duke kobitë
la vinin veglat në darë.*

*Papunësi nuk kishte fare
Siç ka sot në demokraci.
Njerëz tërë ditën në bare
Në atë kohë s'bënte vaki.*

*Me turne femra punonte,
Nuk i thoshte njeri plaç.
Kush guxonte ta ngacmonte
Çohej të nxirr krom në Spaç.*

*Çmimet qenë të kontrolluara
Jo si tashti çmenduri.
Nga shteti ishin fiksuar
S'i ndryshonte dot njeri.*

*Shkolla ish për t'u lakmuar
Diploma merrej me djersë.
Jo si sot me të paguar
Vë çfarë do ti në dëftesë.*

*Qemë pothuaj barabar
Si në rrogë e pasuri,
Në vllazëri s'kish ziliqarë
S'kish smirë si ka tani.*

*Gjitoni ish si vëlla
Të gjendej në çdo sebeb.
Mbas krahëve tashti të ha
Dhe derën me levë ta shqep.*

*S'shijhe lypsar e barbon
As putana e rruspira,
Rrugëve sot kur kalon
I ke turma, lukunira.*

*Ç'qenë fruta e perime
Qenë prodhuar pa hilë,
S'kish hormone në ushqime
Bio, cilësia qe.*

*S'kishte drogëra si tani,
S'njihej coca e hashashi,
E shumta pihej raki,
Ama s'kërciste kallashi.*

*Korrupsioni inekzistent
Pothuaj s'njihej si fjalë,
Sot, të fitosh një të drejtë
Të shkulin dhëmbë e dhëmballë.*

*Kishte rregull, disiplinë
Nuk të prekte kush me dorë,
Jo si tashti ulurimë
Del e të zë plumbi qorr.*

*S'kishte armë në qarkullim
Siç ka sot rrugaçëria,
Të mbaje, përbënte krim,
Ngrysje jetën te qelia.*

*Ishte kohë fukarallëku
Krejt ndryshe nga tani.
Sot vërtetë të mbyt bollëku,
Por ç'e do s'ka qetësi.*

Peskara, tetor 2022



NGA BAJRAM KARABOLLI

POROSIA E GJYSHIT: “KUDO QË TË SHKOSH, MERRE MALIN TËND ME VETE”

Juga e tërbuar, e mbarsur me shi, vër-sulet që nga maja e Bogonicës dhe, duke fshikulluar ç'i del përpara, pret e shkon mbi ne. Jemi te lëmi, në brinjë. Gjyshi, i mbështjellë me shark dhe i mbështetur në një gjineshtër, më merr dhe më fut në shark. Juga rreh fytyrën time, ndërsa barin e hollë e të gjatë, që qan e ankohet te veshi im, e fshikullon dhe e shakullit sa andej-këtej.

– Babo, i kujt është ai mali që na dërgon këtë erë të çmendur?

– Është mali im, o bir, – përgjigjet gjyshi, pa ia ndarë sytë Bogonicës. – Atje kam lindur, atje u rrita dhe u bëra burrë...

– Mali im është Tartari, Babo, – i them unë, gjithë mburrje.

– Mirë, të pastë gjyshi, por mos harro: kudo që të shkosh, merre malin tënd me vete.

– Po lëmin, babo, ta marr me vete?

– Edhe lëmin, bir, merre, por mos harro vidhin, përposh te pusi. Merre edhe vidhin. Kur të lodhesh, shtrihu nën hijen e tij të freskët dhe futja gjumit...

Legjenda dhe ëndrra

Dhe unë bëra siç më porositi gjyshi: E mora me vete lëmin, ku, me gëzimin e të voglit ngisja kuajt për të shirë grurin. Mora me vete vidhin me hije të freskët, për të shuar vapën, kudo që të shkoja. Mora me vete edhe malin tim, Tartarin, me gjithë borë e me gjithë hënë. Si mund të ikja pa të? Nga supi i malit tim dilte dielli që pastaj shkonte e kridhej në det.

Legjenda e vjetër thotë se Zeusi, aty, në errësirën e amshueshme të Tartarit rroposi armiq të tij, Titanët...

...Në gjysmëterr shikoj se si përbindëshat Titanë shqyejnë malin, dalin nga thellësia e tij dhe bëjnë batërdinë. Nuk e di se ç'i kanë bërë diellit. Dielli nuk del më nga supi i Tartarit. O Zot, pse këtu në këtë vend të largët, ku jam tani, edhe dielli edhe hëna ikin mbrapsht?!... Po juga, juga e dashur, pse nuk frynë këtu?

Me siguri, Titanët e tmerrshëm kanë hapur gojën-shpellë dhe e kanë rrufitur jugën e furishme, duke e kapërdirë, si të qenkësh një gllënjë çaji. Ndërsa lëmin tim të dashur, me një shkelje të lehtë këmbë, ma kanë vrarë. Po vidhin, ç'e bënë?...

Takim me vëllain

Ngrihem i llahtaritur dhe, me vrull, vër-sulem jashtë. Gjumi më del plotësisht. Kam vapë. Eci drejt këtij mali të huaj. Përpara shikoj një pemë të madhe. Gjethet i ka të shumta dhe të dendura. Sigurisht ka hije të freskët. Si ka mundësi? Në këtë vend që nuk është imi, pemët janë krejt ndryshe. Afrohem. O Zot! E njoh. Është vidhi. Vëllai im. E përqafoj gjithë mall. I përkëdhel gjethet. Shtrihem në hijen e tij dhe ndihem si në shtëpinë time. Ngrihem të iki, por s'më iket.

– Merr një degëz me gjethe nga unë, vëlla, – më thotë vidhi, gjithë dashuri.

Dhe marrë prej tij një degëz me gjethe, e vendos te xhepi pranë zemrës...

Santiago (Kili), 2002



“Dhe unë bëra siç më porositi gjyshi: E mora me vete lëmin, ku, me gëzimin e të voglit ngisja kuajt për të shirë grurin. Mora me vete vidhin me hije të freskët, për të shuar vapën, kudo që të shkoja. Mora me vete edhe malin tim, Tartarin, me gjithë borë e me gjithë hënë. Si mund të ikja pa të? Nga supi i malit tim dilte dielli që pastaj shkonte e kridhej në det.

FALËNDERIM SPONSORIZUESVE TË SHOQATËS DHE TË GAZETËS



FALËNDERIM PËR SHKËLQIM LAÇAJN (LESKAJ)

Një falënderim në emër të Kryesisë së Shoqatës “Kallarati”, por edhe të lexuesve të uebsajtit të Kallaratit në internet www.kallarati.com për z. Shkëlqim LAÇAJ (LESKAJ), i cili jo vetëm ka financuar hapjen e këtij uebsajti në vitin 2011, por realizon çdo vit mirëmbajtjen e tij me një kuotë të caktuar financiare, duke bërë të mundur që bashkëshatarët e tij kudoqofshin të gjejnë informacionin e nevojshëm për vendlindjen e tyre, KALLARATIN.

Kushdo mund të kontribuojë për vendlindjen jo vetëm financiarisht e materialisht, por edhe me çdo lloj forme tjetër.

Ju mirëpresim!

ADRIAN ABAZI SPONSORIZUESI I RADHËS I GAZETËS “KALLARATI”

Adrian Abazi, edhe pse prej vitesh punon e jeton familjarisht në Itali, nuk e harron vendlindjen e të atit, Nazmiut, ndarë nga jeta para pak kohësh; nuk e harron vendlindjen e gjyshes, nënë Fatimesë, prandaj e quan krenari që është me origjinë nga Kallarati, të cilën e shpreh edhe atje ku punon mes italianëve “Jam nga Kallarati i Vlorës”, dashuri që ua trashëgon edhe fëmijëve të tij. Në një mbasdite në një kafe me të shkëmbyem mendime e kujtime për Kallaratit. Adriani, duke shprehur vlerësimet më të larta për veprimtaritë e shoqatës, e në mënyrë të veçantë pasqyrimin e tyre në fejsbukun, uebsajtin dhe në faqet e gazetës “Kallarati”, mori përsipër mbulimin e shpenzimeve të një prej numrave të të gazetës, pikërisht numrin 110 të radhës.

Kryesia e shoqatës “Kallarati” vlerëson kontributin e tij jo vetëm për gazetën, por në tërësi për dashurinë që shpreh për Kallaratit, të cilën ua përcjell edhe fëmijëve. Faleminderit Adrian!**Kushdo mund të kontribuojë për vendlindjen jo vetëm financiarisht e materialisht, por edhe me çdo lloj forme tjetër.**



NË KUJTIM TË NJËVJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË XHAXHAIT, BUDIN DEMIRI

NGA MBESA, VALGERTA DEMIRI

Si sot një vit më parë u nda nga jeta xhaxhai im Budin Demiri, një njeri i dashur, i urtë, i qeshur, buzagaz, punëtor, e i sinqertë, veti që e bënin atë të veçantë jo vetëm për mua si mbesë e tij, por për të gjithë të afërmit e bashkëshatarët kallarratas e të tjerë që e njihnin, të cilët shprehnin respekt e mirënjohje ndaj tij.

Budini lindi më 12 mars 1936 në Kallarat, në familjen e Sabri e Trëndafile Demirit. Ishte fëmija i madh i familjes, vëlla i gjashtë motrave: Beqares, Shefos, Alidisë, Hurmasë, Hismos e Dushit dhe dy vëllezërve: Lutos e Xhevdetit.

Lindi në një familje të varfër ekonomikisht, po me ndjenja të forta atdhetare, që ka dhënë kontributin e vet në luftërat e viteve 1912–1914 për mbrojtjen e fshatit nga andartët grekë, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe më vonë në ndërtimin e vendit.

Budini u rrit mes vështirësive të shumta, si gjithë fëmijët e atyre viteve. Pasi kreu ciklin parashkollor dhe si fëmija i madh, për t'i ardhur në ndihmë familjes nga ana ekonomike, u angazhua në punët e ndryshme në fshat në bujqësi e blegtori. Ai ishte një njeri i urtë, punëtor dhe i papërtuar për asgjë për vete, për familjen dhe shoqërinë.

Me krijimin e kooperativës bujqësore në vitin 1956, Budini filloi punë si blegtor, ndërsa në vitet 1958–1959 kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe, pasi u kthye në fshat, u angazhua sërish si blegtor. Budini gjithë jetën, si shumë bashkëshatarë të tij, punoi me përkushtim e devotshmëri në sektorin e vështirë të blegtorisë, duke qenë një bari i dalluar. Ai i përket atij brezi të barinjve që gjithë jetën ia kushtoi blegtorisë.

Në vitin 1963 u martua me bijën kallarratese Selime Memetaj, me të cilën lindën e rritën me shumë sakrificë gjashtë fëmijë: Kozetën, Ilirin, Elcën, Edlirën, Artanin dhe Anifen.

Pas viteve '90, me prishjen e kooperativës bujqësore, xhaxhai u mor me ekonominë vetjake, kurse dy djemtë e tij, Iliri dhe Artani, morën rrugët e kurbetit, si gjithë bashkëmoshatarët e tyre. Me punën e tyre ndihmuan familjen nga ana ekonomike, si dhe ndërtuan një dyqan të vogël në qendër të fshatit në Morrez, ku Budini punonte, por në një farë mënyre kalonte edhe kohën, takonte e bisedonte me njerëzit, sidomos me ata të moshës së tij.

Në kujtimet e mia si një fëmijë nëntëvjeçar, ishte fund maji, saktësisht 28 maj 1997, kur në derën e shtëpisë sonë u dëgjuan ulërime dhe pashë njerëzit tanë të afërm veshur me të zeza. Aty mësova që, Iliri djali i madh i xhaxh Budinit, nga një aksident fatal në punë, duke qenë emigrant në Greqi, kishte humbur jetën. E pabesueshme për të gjithë për këtë humbje të madhe në lulen e rinisë. Por kjo fatkeqësi kishte ndodhur. Kjo ishte goditja më e madhe për xhaxhi Budinin, xhaxhe Selimenë, vëllain, motrat, por edhe për të gjithë Demirajt.

Jeta e xhaxhait dhe familjes u turbullua. Ikja e Ilirit në moshën 30-vjeçare, ishte humbje e madhe. Xhaxhi e përjetoi shumë keq humbjen, por në një moment aq të vështirë, si dhe për të mos e pranuar ikjen e djalit, mori guximin dhe u nis i vetëm drejt Greqisë, në



vendin e aksidentit për të parë vetë dhe për të biseduar me banorë të zonës që e njihnin Ilirin, që të mësonte rrethanat e të vërtetën e vdekjes. Ashtu i përhumur, u kthye në fshat për të mbajtur të gjallë kujtimin e të birit, hapi dyqanin dhe filloi të punonte për t'u ushqyer si familje, por edhe për të hequr sadopak mendjen nga tragjedia e ndodhur. Sa herë kaloja për në shkollë, e shikoja atje të heshtur pas banakut, me sytë të përhumur e shpesh

mbushur me lot duke parë fotografinë e Ilirit, e cila qëndronte në mur përmbi banak.

Jeta për të vazhdonte, u gëzua me nipër e mbesa, por dashurinë e tij më të madhe ia kushtoi Armandos, djalit të Artanit. Çdo javë udhëtonte drejt Tiranës për ta takuar. Kaloi vështirësi shëndetësore e fizike, por kurrë nuk u dorëzua e as u ankua, qëndronte gjithmonë i heshtur e me sy të përhumur që fshihnin dhimbjen e madhe.

“ Budini lindi më 12 mars 1936 në Kallarat, në familjen e Sabri e Trëndafile Demirit. Ishte fëmija i madh i familjes, vëlla i gjashtë motrave: Beqares, Shefos, Alidisë, Hurmasë, Hismos e Dushit dhe dy vëllezërve: Lutos e Xhevdetit. Lindi në një familje të varfër ekonomikisht, po me ndjenja të forta atdhetare, që ka dhënë kontributin e vet në luftërat e viteve 1912–1914 për mbrojtjen e fshatit nga andartët grekë, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe më vonë në ndërtimin e vendit.

Vitet e fundit, për shkak të moshës u sëmur, kështu që Artani së bashku me bashkëshorten Anën i morën të dy prindërit në Tiranë dhe u kujdesën e i shërbyen deri sa mbylli sytë më 25 prill 2022, ndërsa xhaxhe Selimeja vazhdon në Tiranë, ashtu e sëmurë, nën kujdesin e djalit e sidomos të nuses, Anës. Xhaxh Budini erdhi në vendlindje në shtëpinë e tij, tashmë të përhershme dhe sot prehet në varrezat e fshatit, duke na lënë si kujtim fjalën e tij të ëmbël e dashurinë e tij të pakufishme.

Por në këtë njëvjetor të mungesës së tij, dua të kujtoj disa çaste nga takimi i fundit me të në Tiranë. Ishte muaj mars 2022, kur shkova së bashku me babin ta takonim. E pashë atje të shtrirë në krevat, rrethuar nga mbulesa të bardha e me një kapuç në kokë, vështirë të gjeje sytë e tij. Ai na njohu, por nuk foli dot. Unë prisja të më thërriste vetëm në emrin që vetëm ai më thërriste, por nuk mundi. Fillova ta ngacmoja si përherë me ato shakatë tona, që vetëm unë e ai i dinim, por përsëri nuk qe e mundur. Prisja të më fliste, por hasa vetëm në sy mbushur me lot, të cilët folën për mallin, kujtimet edhe dhimbjen që ai mbarte mbi supe për shumë vite. Edhe pse i premtova se do ta vizitoja sërish, ai qe takimi ynë i fundit. Xhaxhi i mbylli sytë dhe iku i qetë pranë djalit të tij, Ilirit.

U prehsh në paqe xhaxhai im i mirë! Do të të kujtojmë përherë!

KUJTOJMË SHAKAJT E NDARË PARA KOHE NGA JETA

Enkeleda Hoxhaj, vajza e Lavdi e Sose Hoxhaj (Shakaj), mbesë e Pelivan e Nako Shakaj, nëpërmjet fejsbukut të shoqatës "Kallarati", në kujtim të 41-vjetorit të humbjes së jetës në mënyrë tepër tragjike të tezes së saj Minushes, pikërisht më 28 qershor 1982 në krye të detyrës, duke bërë tëndën e kopesë së dhenve, së bashku me anëtarët e tjerë të brigadës së Kallaratit, atje në malin e lartë të Bogonicës, nëpërmjet dedikimit të mëposhtëm, përcjell lot, dhimbje dhe kujtesë për të, nënën e saj, por edhe për tezet e tjera e dajon e vetëm Luanin, ndarë edhe këta para kohe nga jeta, si dhe gjyshin Pelivanin dhe gjyshen Nakon, ndarë nga jeta para një viti.

Pelivani, një blegtor i zoti, së bashku me Nakon, lindën e rritën me sakrificë dhjetë fëmijë, por në vitet e pleqërisë së tyre u helmuan së tepërmi me ndarjen e njëspasnjëshme nga jeta të 5 fëmijëve të tyre. Megjithatë, ata gjetën forcë e kurajë për t'i përballuar këto humbje, edhe pse me dhimbje të madhe. Ndosh-ta rastësisht, por muajt prill e qershor, për këtë familje, kanë qenë muaj fatalë, muaj zie e pikëllimi, pasi në këta muaj u janë shkëputur me radhë para kohe nga jeta disa pjesëtarë të kësaj familjeje të madhe.

Ja si shkruan Enkeleda në dedikimin e saj:

Kujtojmë mes lotësh tezen tonë Minushen. Më 28 qershor 1982 zoti e desh për vete në moshën e rinisë. E qeshura e saj ngriu në malin e Bogonicës. Dhembja dhe dashuria që kanë pasur nëna, motrat dhe vëllai i vetëm për Minushen ka qenë e madhe. Aq e madhe, saqë motrat Sosia në 11 qershor të 1992 dhe



Mara në 19 qershor të 1992 iu bashkuan në botën e përjetshme Minushes, duke lënë fëmijët të vegjël. Dhembja nuk u mbyll aty, po më 7 prill të 2014 u bashkohet Luani, vëllai i vetëm, dhe në 19 prill të po këtij viti edhe motra tjetër, Tatiana.

Mes këtyre dhembjeve, gjyshja gjeti forcë të na falte dashuri, ngrohtësi dhe këshilla për të qenë krenarë në jetë. Fjalët e saj të ëmbla na shoqëruan deri në 11 qershor të vitit 2022, ditë kur gjyshja jonë 94-vjeçare gjeti qetësinë e saj shpirtërore pranë fëmijëve të vet në parajsë. Ajo iku në parajsë, me të vërtetë në një moshë të madhe, por jo siç duhet të largohet një gjyshe, që lindi e rriti 10 fëmijë, pasi përveç përballjes me vdekjet e njëspasnjëshme të vajzave dhe djalit të vetëm, në gusht të vitit 2011 iu desh të përjetonte edhe një tjetër dhimbje të madhe, humbjen e nipit të saj, Spartakut 26-vjeçar, djali i Haires dhe Sakos në Divjakë.

Hallet për të gjithë ne nipër e mbesa janë të mëdha, humbjet nuk harrohen, por jetën do ta jetojmë edhe pse me dhimbje. Ne do ju kujtojmë me dashuri dhe krenari të gjithë juve në atë botë të largët, – përfundon dedikimin e saj Enkeleda.

Me këtë dhimbje e këtë kujtesë për gjithë Shakajt e ndarë para kohe nga jeta, bashkohemi edhe të gjithë ne kallaratasit. Mirënjohje dhe qofshin të paharruar për jetë!

Kryesia e shoqatës "Kallarati"

NDAHET NGA JETA ZELIDE TAFIL BOÇAJ (RIBAJ)

Më 8 prill 2023 u nda nga jeta Zelide Boçaj (Ribaj), bashkëshortja e Muhamet Boçajt (ndarë nga jeta), nëna e Donikës, Shkëndisë e Dritan Boçajt, motra e Haxhikës, Hurmasë, Dritës, Takdires (ndarë nga jeta), Luljetës, Caushit (ndarë nga jeta) e Hekuran Tafil Ribajt. Zelideja lindi në Kallarat në vitin 1946, në një familje me ndjenja të theksuara atdhetare, nga prindërit Tafil e Pajame Ribaj. Ajo u martua me Muhamet Boçajn, i cili u nda nga jeta para kohe. E mbetur e vetme, Zilidesë i ra barra e rëndë që e vetme të rriste, edukonte e shkollonte tre fëmijët e tyre: Donikën, Shkëndinë e Dritanin. Zelideja punoi për shumë vite në Kallarat në detyra të ndryshme, magaziniere, shitëse, në çerdhe e

në punët e bujqësisë. Ajo ishte një grua e urtë e punëtore që manifestohet cilësitë më të mira të një gruaje, nëne e gjysheje shembullore dhe gëzonte respektin më të madh të gjithë bashkëfshatarëve të saj. Vitet e fundit ajo u largua nga Kallarati për të jetuar pranë fëmijëve në Greqi e Gjorm, por për asnjë çast ajo nuk e ndau dashurinë për vendlindjen, Kallarat, për njerëzit e banorët e tij. Me ndarjen e saj nga jeta, fëmijët humbën njeriun e tyre të dashur, por edhe Kallarati, humbi një grua zonjë, që i lartësoi vlerat vendlindjes. Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh fëmijëve, familjeve Boçaj e Ribaj, ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA NJERIU SHEKULLOR I
KALLARATIT, GANI HAJDIN BRESHANAJ

Më 21 maj 2023 u nda nga jeta një nga kallaratasi që sfidoi shekullin, Gani Hajdin Breshanaj, në moshën 101 vjeçare. Ganiu lindi në Kallarat të Vlorës më 1 janar të vitit 1923 nga prindërit Hajdin dhe Qeriba Breshanaj, të cilët ndërruan jetë duke e lënë jetim në moshën 3-vjeçare. Në moshën 7-vjeçare ai u muar nën kujdesin e dy prej miqve të babait të tij në fshatin Vuno të Himarës dhe gjithë fëmijërinë e tij kaloi atje. Ai kontribuoi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke u inkuadruar në Brigadën e 12-të Sulmuese, së bashku me shumë bashkëfshatarë të tjerë kallaratasi. Pas çlirimit të vendit, Ganiu mori pjesë në forcat e Sigurimit të Shtetit për eliminimin e bandave në veri të vendit. Më vonë, u kthye në vendlindje. Në janar të vitit 1953 u martua me Feride Haxhiajn dhe nga kjo martesë lindën 9 fëmijë: Nakon, Fatoshin, Petron, Thëllëzën, Eftalinë, Agronin, Verën, Viktorin dhe Trendelinën. Fillimisht ata jetuan së bashku në Kallarat (Grykë e Lëmit) për disa vjet dhe më pas u larguan për të punuar e jetuar në Llakatund të Vlorës. Në 2003 u vendosën në qytetin e Vlorës, së bashku me djalin e tyre Agron Breshanaj, ku jetuan pjesën tjetër të jetës së tyre të lumtur me vajzat dhe djemtë, të rrethuar me nipër/mbesa e stërnipa/stërnbesa. Kudo ku punoi e jetoi, Ganiu së bashku me familjen e tij la përshtypje të mira. Me ndarjen e tij nga jeta, djemtë e vajzat nipërit, mbesat, stërnipërit e stërnbesat humbën njeriun e tyre të dashur, por



edhe Kallaratit humbi një burrë që i lartësoi vlerat vendlindjes, një burrë shekullor.

Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh familjes së Ganiut dhe fisit Breshanaj, ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!

IN MEMORIAM

NDAHET PARA
KOHE NGA JETA
KASTRIOT
ARIZ GOXHAI

Më 10 maj, pas një sëmundje të rëndë në Amerikë, është ndarë para kohe nga jeta kallaratasi, Kastriot Ariz Goxhaj, vëllai i Refitit, Agronit, Dianës e Teutës. Kastrioti lindi në Selenicë të Vlorës nga prindërit Aris e Qamile Goxhaj, në një familje me ndjenja të theksuara atdhetare. Prindërit e tij kanë lindur në Kallarat dhe pas Çlirimit u vendosën në Selenicë. Vitet e fundit Kastrioti kishte emigruar për një jetë më të mirë në Amerikë.

Kryesia e Shoqatës Kallarati u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta vëllezërve dhe motrave për humbjen e vëllait të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi dhe emri i Tij! U prehtë në Paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA BEJAZE MEMUSHAJ (ABAZAJ)

Më 4 maj 2023 u nda nga jeta Bejaze Memushaj, bashkëshortja e veteranit të luftës antifashiste nacionalçlirimtare, Dalan Memushaj (ndarë nga jeta), nëna e Liljanës, Vojsavës, Mimozës, Lavdiës dhe Almirës. Bejazja lindi në Kallarat më 23 janar 1931 në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e liridashëse nga prindërit Zimo e Kadënë Abazaj. Ajo edhe pse në moshë të re u aktivizua në lëvizjen antifashiste nacionalçlirimtare në Kallarat, mori pjesë në aksionet e rinisë të pasluftës për rindërtimin e vendit dhe gëzonte statusin e Veteranit. Ajo u martua me Dalan Memushaj nga Kallarati, ish partizan i Brigadës së Parë Sulmuese dhe më vonë oficer i lartë i Ushtrisë Popullore me të cilin lindi, edukuan e arsimuan 5 vajza të denja për familjen e shoqërinë. Si Dalani edhe Bejazja kudo ku punuan manifestuan cilësitë më të larta të një familjeje të denjë për shoqërinë. Të dy përveç punërave shtetërore

ishin veprimtarë të shquar në lagje e në qytetin e Tiranës. Ata tregonin dashuri të madhe për vendlindjen Kallaratit dhe gjithë bashkëfshatarët e tyre në Kallarat, por edhe në Tiranë. Shtëpia e tyre ishte e hapur për këdo kallaratasi dhe jo vetëm. Ata kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për Kallaratit, ngritjen e Muzeut të luftës antifashiste nacionalçlirimtare, për shoqatën dhe gazetën Kallarati. Bejazja ishte një grua e thjeshtë, një bashkëshorte e denjë, një nënë e mrekullueshme dhe një gjyshe e dashur. Vitet e fundit vuajti nga një sëmundje e gjatë, por nën kujdesin e vazhdueshëm të vajzave, dhëndurrëve, nipërve e mbesave. Me ndarjen e saj nga jeta, vajzat humbën njeriun e tyre të dashur, por edhe Kallaratit, humbi një grua zonjë, që i lartësojë vlerat vendlindjes e më gjerë. Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh vajzave, fisit Memushaj e Abazaj ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA SELIME
DEMIRAJ (BEJTAJ)

Më 10 maj 2023, pas një sëmundjeje të gjatë, në Tiranë është ndarë nga jeta në moshën 82 vjeçare Selime Demiraj, bashkëshortja e Budin Demirit (ndarë nga jeta), nëna e Artanit, Kozetës, Edlirës, Elsës dhe Anës. Selimeja u lind në Kallarat më 2 shkurt 1941 në familjen Bejtaj (Mehmetaj) familje kjo me ndjenja të larta patriotike e liridashëse. Selimeja në vitin 1963 u martua me Budin Demirin dhe lindi e rriti në sakrificë 6 fëmijë, Kozetën, Elsën, Edlirën, Anën, Ilirin (ndarë nga jeta) dhe Artanin. Selimeja gjithë jetën punoi me përkushtim e devotshmëri në sektorin e bujqësisë. Ajo ishte një grua e urtë e punëtore, por që në vitin 1997 u prek shumë me humbjen e parakohshme të djalit të saj Ilirit, si pasojë e një aksidenti automobilistik në Greqi. Vitet e fundit të jetës, së bashku me bashkëshortin Budinin (i cili u nda nga jeta një vit më parë), duke qenë e sëmure i kaloi në Tiranë pranë djalit të saj Artanit, i cili së bashku me bashkëshorten e tij Anën u shërbyen prindërve deri në fund të jetës së tyre. Kryesia e Shoqatës Kallarati u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta fëmijëve dhe të afërmeve të saj. Qoftë i paharruar kujtimi dhe emri i Saj! U prehtë në Paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET PARA KOHE NGA JETA
BUDIN KARAFIL JONUZAJ

Më 16 Qershor 2023 pas një sëmundjeje të gjatë e të rëndë është ndarë para kohe nga jeta, Budin Jonuzaj, djali i Karafilit, vëllai Nasipit, Mirjanës, Alimes, Kastriotit, Bestrovës, Dashos, Ibros, Shpëtimit, Edlirës dhe Mimozës, bashkëshorti i Aldës dhe babai i Klevit, Denadës dhe Donatelës.

Budini lindi në Penkovë të Vlorës më 12 Mars 1967 në një familje me ndjenja të thella patriotike e atdhetare me origjinë nga Kallarati, nga prindërit, Karafil e Merfa Jonuzaj. Kudo ku punoi Budini, manifestimi cilësitë më të larta ndaj familjes dhe shoqërisë, duke qenë një djal i dashur për prindërit, vëllezërit dhe motrat, prind i shkëlqyer për fëmijët, bashkëshorti i denjë për bashkëshorten dhe shok i mirë për shoqërinë e tij. Pas një beteje të gjatë me sëmundjen e pashërueshme jeta e tij u pre në mes, duke lënë në pikëllim prindërit, vëllezërit, motrat bashkëshorten, fëmijët e të afërmit. Ai e donte shumë jetën, familjen, fëmijët e tij ende të vegjël dhe të gjithë njerëzit, por sëmundja me gjithë përpjekjet e familjes nuk pyeti, duke e shpëputur para kohe nga familja e shoqëria. Kryesia e Shoqatës Kallarati, u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta, familjes e të afërmeve për këtë humbje të madhe. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



Kryesia e Shoqatës "Kallarati" u shpreh gjithë familjeve dhe të afërmeve të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur.

Qofshin të paharruar!



Gurghdhendësi Agim Kallarati (Mataj)

Gurëgdhendësi Agim Mataj (Kallarati) ka vite që e ushtron këtë zana me mjaft pasion e dëshirë në Leçe të Italisë, pasion që fillësat e tij i ka në fëmijëri, në vendlindjen e tij në Kallarat. Në vitin 1993, për arsye ekonomike, Agimi emigroi në Leçe të Italisë. Aty iu përkushtua punimit artistik të gurit, duke tërhequr vëmendjen e biznesmenëve dhe të njerëzve të kulturës dhe të artit italian. Punimet e tij janë kryesisht oxhaqe guri e tavolina për dhoma pritjeje në variantin "Barroko Leçe", kolona "Kapitelo", harqe, veshje, stilizime të skulpturës dhe skulpturë realiste, orë muri e tavoline etj. Në vitin 2004 ka marrë pjesë në dy në panairë në Vlorë e Tiranë me punimet e tij artistike prej guri, duke u nderuar edhe me diplomë të veçantë. Punimet e tij i gjen sot jo vetëm në Itali, por edhe në shumë shtete të Evropës si në Angli, Francë Zvicër, Belgjikë, Austri, por edhe në Amerikën e Japoninë e largët. Punime prej guri Agimi ka bërë edhe në vendlindjen e tij në Kallarat, në Kucbaba Vlorë dhe shprehet i gatshëm të bashkëpunojë me bashkinë e Vlorës për të realizuar punime artistike sipas projekteve të saj.

Agimi tashmë në çdo punim që bën me krenari identifikohet me emrin mjaftë kuptimplotë e të bukur, "AGIM KALLARATI".


Për t'u plotësuar dëshirën dhe kuriozitetin e disa prej lexuesve, të gazetës Kallarati, më poshtë po paraqesim në foto disa prej punimeve të tij, fotografuar në studion e punës.



Ec ngado

KALLARATIN

mos e harro!



Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Anëtarë:
Prof. dr. Rami MEMUSHAJ,
Hiqmet MEÇAJ,
Fatmir MATAJ,
Çize XHAFERAJ,

Redaksia e Gazetës:

Eleni MEMUSHAJ,
Besnik GJONBRATAJ,
Riza MEMUSHAJ,
Selo QEJVANI.

REDAKTOR/KORREKTOR:
PROF. DR. RAMI MEMUSHAJ

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ